



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1042/5 Prot.

Tiranë, më 20/9/2013

Lënda: Rekomandim për "Klinika Dentare Italiane C.D.I", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 21, datë 20/09/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit ,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Klinika Dentare Italiane C.D.I" Tiranë me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale dhe të drejtat e subjekteve (nenet 5-9 dhe nenet 12-16)
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe kofidencialiteti (nenet 27,28).
- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21).

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Për kategorinë "pacientë" gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale si emri, mbiemri, data e lindjes, gjinia, mosha, numri i telefonit, adresa, diagnoza, të dhëna mbi alergjitë e mundshme, grafi të dhëmbëve dhe fotografi. Këto të dhëna mblidhen nga personeli i mjekëve përmes plotësimit të kartelës (modulit) për mbrojtjen e privatësisë së pacientit.

Sekretarja e përgjithshme dhe dy nga stomatologët e kontrolluesit deklaruan se të dhënat personale të pacientëve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilin ato mblidhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për pacientët është vetëm ofrimi i shërbimeve në fushën e stomatologjisë.

Në lidhje me objektin e kontrollit u konstatua se Kontrolluesi "Klinika Dentare Italiane" nuk kishte realizuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen

e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, por kontrolluesi e plotësoi menjëherë Formularin e Njoftimit (manualisht) dhe u dorëzua pranë Zyrës së protokollit të KMDP-së.

Për sa i përket të dhënave të sipërcituara përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi se mbledheshin me pëlqimin e pacientëve dhe ky pëlqim provohej në formë të shkruar me anë të kartelës (modulit) për mbrojtjen e privatësisë, por në përputhje dhe zbatim të Ligjit Italian. Në kartelën e pacientit nuk ishte i cituar Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Gjithashtu, gjatë kontrollit u konstatua se të dhënat personale të klientëve mbaheshin për një afat të pacaktuar. Për sa i përket kohës së ruajtjes së të dhënave personale sipas shkronjës d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit, në të cilin përcaktohet se të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në këtë rast duhet të respektohen afatet e parashikuara në kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.

Në lidhje me sigurinë e të dhënave personale të pacientëve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), u konstatua se:

- Kontrolluesi ka të administruara në kompjuter disa dosje me emër, mbiemër të pacientëve si dhe fotografi të tyre vetëm të pjesës së dhëmbëve, jo të fytyrës. Të dhënat në këto dosje ruhen që prej krijimit të klinikës. Administrator i këtij sistemi është vetë kontrolluesi dhe hapja e kompjuterit bëhej me anë të një fjalëkalimi dhe aty kishin akses të 5 mjekët stomatolog. Në këtë kompjuter secili nga mjekët kur aksesonte këto dosje nuk hynte me një fjalëkalim hyrës të ndryshëm nga njëri-tjetri me qëllim identifikimin e tij gjatë përdorimit të të dhënave të pacientëve. Aksesit nëpërmjet emrit/fjalëkalimit duhet të jetë i personalizuar për çdo përdorues.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme për sigurinë e të dhënave personale që përpunon.
- Personat që kanë akses në dosjet e pacientëve të cilat përmbajnë emër, mbiemër të pacientit, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale (në zbatimin e nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).
- Të përfshihet në kontratat e punëmarrësve (mjekëve dhe ndihmësmjekëve që kanë akses në dosjet e pacientëve) një aneks në të cilin të parashikohen detyrimet për ruajtjen e konfidencialitetit.

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

- **Neni 27 pika 2/1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregulloret të tjera”

- **Neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi, përpunuesi dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë kofidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.....”.

- **Neni 18 pika 1 e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin.....”.

- **Neni 5 pika 1 d) e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Mbrojtja e të dhënave personale bazohet: në mbajtjen në atë formë, l që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të pacientëve. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqer. zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Të bëhet ndryshimi në kartelën e privatësisë së pacientit (modul), ku të hiqet Ligji Italian për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të citohet Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, duke u shoqëruar me të gjithë informacionin e kërkuar nga neni 18, si dhe Udhëzimi nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.
3. Ç’do përdorues që hyn në kompjuterin ku administrohen dosjet e pacientëve me të dhënat e tyre, ti aksesojë ato në mënyrë të kufizuar vetëm nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës të personalizuar.
4. Të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Të respektohen afatet e parashikuara në kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.
5. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të përfshihet në kontratat e punëmarrësve (mjekëve dhe ndihmësmjekëve që kanë akses në dosjet e pacientëve) një aneks (deklaratë) në të cilin të parashikohen detyrimet për ruajtjen e kofidencialitetit.

6. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
7. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
8. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

